

MARREVEESHJE PER SHITBLERJE AKSIONESH



DATE 16 DHJETOR 2019

Mes

Shoqeria "AL&GI" Shpk.

Shitesi

Alban Mehmeti

dhe

[Signature]

Shoqeria "Hysenbelliu" shpk

Bleresi

Arto Lina

[Signature]



Pasqyra e Lendes

1	PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET	6
1.1	PERKUFIZIMET	6
1.2	INTERPRETIMET	8
1.3	KONFLIKTET	9
2	OBJEKTI DHE QELIMI I TRANSAKSIONIT	10
2.1	SHITJA DHE BLERJA E AKSIONEVE	10
2.2	KOHA E KAUMIT TE PRONESISE MBI AKSIONET	10
2.3	TRANSFERIMI I PRONESISE TE AKSIONEVE	10
2.4	MOS APLIKIMI I TE DREJTES SE PARABLERJES	10
3	ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES	11
3.1	ÇMIMI I BLERJES	11
3.2	MENYRA E PAGESES PER ÇMIMIN E BLERJES	11
4	DATA E NENSHKRIMIT DHE KUSHTET	12
4.1	NENSHKRIMI	12
4.2	KUSHTET NE DATEN E NENSHKRIMIT	12
5	KALIMI I AKSIONEVE	13
6	KUSHTET PARAPRAKE TE NENSHKRIMIT	14
6.1	KUSHTET PARAPRAKE NEN PERGJEGJESINE E SHITESIT	14
6.2	KUSHTET PARAPRAKE NE PERGJEGJESINE E BLERESIT	143
6.3	MARREVESHJET E PERBASHKETA NE LIDHJE ME KUSHTET PARAPRAKE	143
7	DEKLARATAT DHE GARANCITE	14
7.1	DEKLARATAT DHE GARANCITE E BLERESIT	14
7.2	DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT	154
8	PRETENDIME PER DEMET	15
8.1	DETYRIMET E SHITESIT	15
8.2	DETYRIMET E BLERESIT	15
9	ZGJIDHJA	15
9.1	SHKAKU I ZGJIDHJES DHE NJOFTIMI	15
10	LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJET E MOSMARRVESHJEVE	16
10.1	LIGJI I ZBATUESHEM	16
10.2	JURIDIKSIONI	16



11	TE NDRYSHME	16
11.1	FORCA MADHORE	16
11.2	NJOFTIME	16
11.3	MARREVESHTJA E PLOTE / NDRYSHIMET	17
11.4	KALIMI	17
11.5	EFEKTI DETYRUES	17
11.6	NDASHMERIA	17
11.7	MJETE TE TJERA	17
11.8	HEQJE DORE	17
11.9	KOSTOT DHE TAKSAT	17
11.10	KONFIDENCIALITETI	18
11.11	GJUHA DHE KOPJET	18

LISTA E ANEKSEVE



ANEKSI 1: Autorizimet e Bleresit dhe te Shitesit

ANEKSI 2 Statuti i Shoqerise "Birra Tirana" sha

ANEKSI 3 Dokumentacioni mbi kredine e dhene nga Banka e Tiranes sha

A large, stylized handwritten signature in black ink, located in the bottom left corner of the page.

A smaller, stylized handwritten signature in black ink, located in the bottom right corner of the page.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E NOTËRISË

DEGA VENDORE TIRANË

Nr. 4283 Rep.

Nr. 9731 Kol.



AKT - MARREVESHJE

Sot, me datë 10. 12. 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën personalisht para meje notere Edlira S. HYSENI, me adrese te ushtrimit te aktivitetit në Tiranë, Bulevardi "Zogu I", pallati 12 katësh, kati i dytë, pranë Godinës së "Zërit të Popullit" palët kontraktuese si vijon:

- I. Shoqëria "AL & GI" Sh.p.k , eshte nje person juridik shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit në datën 30.07.1997, me NUIS: J82020004P, me seli ligjore ne adrese: Rr. "Deshmoret e 4 shkurtit", njesia administrative nr. 10, perballe kishes, prane ILDKP, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga z. Alban Xhaferi, rregullisht i autorizuar per qellim te kesaj Marreveshje;

Ne vijim, se bashku referuar si "Shitesi",

dhe

- II. Shoqëria "Hysenbelliu" shpk , person juridik shqiptar, rregjistruar ne Regjistrin Tregtar me nr NIPT J81813004C, me seli në adresën: rruga "Panorama", pranë Hotel "Prestige", përfaqësuar nga Administratori, Znj. Arta Sino, e bija e Besnik, lindur më 22.03.1987, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga "Myslym Shyri", Pallati 5, Shkalla 3, Apartamenti 17, mbajtëse e Letërnjoftimit me nr. personal I75322010K, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar ;

Ne vijim referuar si "Bleresi",

Shitesi dhe Bleresi jane te referuar ne menyre individuale ne vijim si "Pale" dhe se bashku referuar si "Palet".

HYRJE:

- (A) Shitesi eshte aksioner i shoqerise "Birra Tirana" sha, nje shoqeri aksionere , e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit te Repubikes se Shqiperise, regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit me numer unik biznesi (NIPT) J61821051F, me adrese: Rruga "Kavajes", Tirane, Shqiperi.
- (B) Bleresi i ka dorezuar Shitesit nje oferte, duke shfaqur interesin e tij per te blere 19.48 % te aksioneve qe Shitesi zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha.
- (C) Aksionet qe Shitesi zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha, jane si me poshte:

- i. Shoqeria "AL&GI" shpk, zoterues i 216,418 aksioneve, qe perfaqesojne 19.48% te kapitalit;
- (D) Shitesi shpreh vullnetin e tij per te shitur dhe Bleresi shpreh vullnetin per ta blere nga Shitesi aksionet, te cilat perfaqesojne 19.48 % te kapitalit te aksioneve te Shoqerise "Birra Tirana" sha, ne perputhje me kushtet dhe detyrimet e kesaj Marreveshje.
- (E) Organet vendimmarrese te Bleresit miratuan blerjen e aksioneve te Shoqerise "Birra Tirana" sha sipas kushteve dhe detyrimeve te percaktuara ne kete Marreveshje dhe kane miratuar autorizim(et) perkates per nenshkrimin e kesaj Marreveshje, te perfshira ketu si Aneksi 1 (Autorizimet e Bleresit dhe te Shitesit);

Duke marre ne konsiderate marreveshjet e dyanshme te pershkruara ne kete dokument, lidhin kete marreveshje per shitblerjen e aksioneve "Marreveshja", si me poshte:

1 PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1 Perkufizimet

Pervec rasteve kur kjo Marreveshje kerkon ose referon ne terma te ndryshem dhe ne vazhdim te kushteve te percaktuara ne vende te tjera te kesaj Marreveshje (duke perfshire Hyrjen dhe Anekset bashkengjitur), tjalet do te mbartin keto kuptime:

"Aksionet e Birra Tirana sha"	Ka kuptimin te parashikuar ne piken C te Hyrjes;
"Marreveshje"	nenkupton kete marreveshje shitblerje aksionesh duke perfshire anekset bashkengjitur;
"Autorizim"	nenkupton autorizimet, lejet, licencat, miratimet, deklaratat, autorizimi i kerkuar nga Bleresi ne menyre qe te kryeje transakcionin ne aktivitetet perkatese te biznesit;
"Çmimi i Aksioneve te Birra Tirana sha"	nenkupton EURO 1.800.000 (nje milion e teteqindmje Euro) pa perfshire taksat e zbatueshme;
"Dite Pune"	nenkupton çdo dite kalendarike e ndryshme nga e shtuna dhe e diela dhe çdo dite tjetere ne te cilen bankat nuk punojne ne Tirane, (Shqiperi);
"Informacion Konfidencial"	nenkupton çdo informacion ne lidhje me kushtet dhe detyrimet e kesaj Marreveshje, gjithashtu edhe çdo informacion jopublik i arritur ne negociatat e kesaj Marreveshje. Informacioni konfidencial nuk do te perfshije informacion i cili ka qene ose eshte bere publikisht i aksesueshme;

"Informacion i Dhene"

nenkupton mbledhjen e dokumenteve, materialeve, dhe informacion i bere i disponueshem per Bleresin, dhe i gjithë informacioni i corezuar me ane te emailit ose ne ndonje menyre tjeter ne forme te shkruar, gjate negociatave deri ne Datën e Nenshkrimit;

"Force Madhore"

nenkupton çdo urdher, rregullore ose udhezim te qeverise, qofte ne formen e nje ligji ose ndryshe, ose çdo sanksion me natyre kombetare ose nderkombetare, kryengritje, trazira, shqetesime civile, lufte (e deklaruar ose e padeklaruar) akte ose kercenime nga terroriste, grupe guerile apo individe te ketyre grupeve, zjarri, permbytje, termet, sulme, bllokade apo çdo lloj ndodhie e shkakuar pa faj ose neglizhence te Paleve, ose secilit prej tyre, te cilat mund te jene ose jo te ngjashme me sa permendur me lart, me kusht qe kjo ngjarje te jete pertej kontrollit te arsyeshem te Pales se prekur;

"Autoritet Shteteror"

nenkupton çdo gjykate apo autoritet gjyqesor ose qeveritar, administrativ ose organ rregullator, Department, agjenci, komision, autoritet;

"Humbje" ose "Humbjet"

nenkupton çdo demtim (duke perfshire demin aktual te shkakuar dhe fitimin e munguar, demin direkt dhe indirekt, ne cilendo suate te parashikuar apo jo), duke perfshire kostot dhe shpenzimet (duke perfshire tarifat ligjore apo gjyqesore), humbje ose pergjegjesi;

"Garancite e Shitesve"

nenkupton perfaqesimet dhe garancite e Shitesit te rregulluara ne piken 7.2.1 (Organizimi) duke perfshire deri dhe piken 7.2.4 (Gjendja financiare dhe aktiviteti i "Birra Tirana" sha);

"Data e Nenshkrimit"

nenkupton daten kur Marreveshja eshte e nenshkruar rregullisht rga te gjitha Palet;

"Data e pagimit te cmimit te plote te shitjes"

nenkupton daten e kalimit te plote te fondeve/cmimit te shitjes ne llogarine bankare te shitesit nepermjet disbursimit te fondeve te kredise qe Bleresi do te marre per kete qellim tek "BANKA e TIRANËS" Sh.A.

"Data e disbursimit te kredise"

nenkupton daten e disbursimit te fondeve te kredise qe Bleresi do te marre tek "BANKA e TIRANËS" Sh.A me qellim pagesen e plote te cmimit te shitjes te aksioneve.



"Autoriteti Tatimor"

nenkupton çdo autoritet tatimor ose autoritet shtetëror kompetent për të vendosur çdo detyrim tatimor, apo përgjegjës për administrimin dhe/apo mbledhjen e taksave, ose zbatimin e ndonjë legjislacioni fiskal;

"Taksa"

nenkupton të gjitha taksat (përfshirë TVSH dhe taksën e transferimit), tatimet, detyrimet (doganore ose ndryshe), importet detyrimet dhe tatimet në burim të çfaredolloj natyre, duke përfshirë (pa asnjë limit) taksat mbi të ardhurat bruto dhe neto, kontributet e sigurimeve shoqërore, fitimet ose të ardhura dhe taksat në faturime, shitje, përdorim, profesion, franshize, TVSH dhe taksa mbi pronën, së bashku me të gjitha gjërat, detyrimet dhe interesat në lidhje me secilin prej tyre;

"Dokumentet e Transaksionit"

nenkupton këto Marrëveshje dhe çdo dokument të paraqitur ose shpërndarë në përputhje me secilin prej tyre pas Dates së Nenshkrimit;

"Transaksioni"

nenkupton shitjen dhe blerjen e Aksioneve të Birra Tirana shtetërore nga Shitësi të Blerësi, parashikuar në këto Marrëveshje.

1.2 Interpretimet

Në këto Marrëveshje (duke përfshirë përkrahimin dhe anekset), përveç nëse kërkohej ndryshe ose nëse është specifikuar ndryshe në vijim:

- Gjinia mashkullore do të përfshijë gjininë femërore dhe gjininë asnjënjësore dhe numri njeës do të përfshijë numrin shumë dhe anasjelltas;
- Referimet në marrëveshje në nen dhe anekse, janë nene dhe anekse të kësaj Marrëveshje (vetëm nëse konteksti kërkon ndryshe);
- Titujt janë të përfshirë vetëm për lehtësi dhe nuk mbartin efekt interpretimi të kësaj Marrëveshje;
- Përveç rasteve kur është e përfshirë në mënyrë eksplicite, çdo dispozitë e kësaj Marrëveshje e cila është detyruese për më shumë se një person, përveç rasteve kur konteksti parashikon ndryshe, do të detyroje në mënyrë të ndarë apo të bashkuar secilin prej tyre;
- Referimet mbi procesin e shkrirjes së një personi përfshijnë perzierjen, shpërberjen, falimentimin, likuidimin, ose bashkimin e atij personi me çdo person tjetër ekuivalent ose çdo veprim tjetër analog në bazë të së cilit ky person është i regjistruar, ka vendbanim, është rezident, operon biznesin ose ka asete.
- Çdo referim në libra, regjistrim ose informacion ndryshe nënkupton librat, regjistrim apo çdo informacion tjetër të çfaredolloj forme përfshirë materiale në letër, mënyrë elektronike apo vendosja në CD (magnetik media), filmime dhe mikrofilma.



- Nje referim ne çdo ligj, rregullore, statut apo ne dispozita te tjera statutore do te interpretohet si nje referim tek akti ne fjale, si ky mund te ndryshohet, modifikohet ose rimiratohet kohe pas kohe;
- Nje referim ne çdo marreveshje do te perfshije çdo ndryshim, modifikim dhe shtese apo shfuqizim, te cilat mund te hyjne ne fuqi ne çdo moment, perveç rasteve kur parashikohet ndryshe;
- Referencat ne çdo dokument te miratuara "sipas formes se rene dakord" jane dokumentat ne formen dhe me brendi te rene dakord nga Palet, dhe sigluar nga ose per Palet per identifikim;
- Referimet te "nje person i trete" apo "pale e trete" do te interpretohen duke perfshire çdo person te ndryshem nga palet e kesaj Marreveshje;
- Nje shoqeri eshte e kontrolluar nga nje tjetër ("personi kontrollues" i tij) ne qofte se personi tjetër, ne menyre direkte apo indirekte, nepermjet nje ose disa shoqerive te kontrolluara ose personat e tjere kontrollues:
 - o Ka ne pronesi shumicen e interesit pasuror ose te se drejtes se votes ne te;
 - o Eshte anetar apo ortak i saj, dhe ka te drejten per te emeruar apo shkarkuar shumicen e drejtove, bordit drejtues ose te nje organi tjetër ekuivalent;
 - o Eshte nje anetar ose ortak i saj dhe ka kontroll te plote, ose ne mbeshtetje te nje marreveshje me ortakët ose anetarët e tjere, ka shumicen e interesit ose te drejtes se votes ne te.
 - o Ka te drejten ose mund te ushtroje faktikisht nje influence mbi ata te drejte, per shembull (i) duke patur te drejten ose duke patur mundesine te jape udhezime ne lidhje me politikat financiare apo operative, me te cilat drejtoret jane te detyruar ta zbatojne apo do te pajtohen me to, (ii) nepermjet parashikimeve ne dispozitat e memorandumit ose statutit te shoqerise apo akteve te shoqerise, (iii) nepermjet nje kontrate kontrolli se marreveshje ortakësh; ose
 - o Ka nje interes pjesemarrës ne te dhe ose ushtron nje influence kontrolli mbi te ose te dy shoqerite drejtohen ne menyre te unifikuar;

Dhe perkufizimet "shoqeri te kontrolluara" dhe "personat kontrollues" duhet te interpretohen ne perputhje me to.

- Nje detyrim i nje Pale per te "siguruar" nje veprim, mundesi ose tolerim per nje veprim nga nje person i trete do te nenkuptoje nje detyrim ne perfundim dhe nje premtim detyruës e asaj Pale per aktin, mundesine apo tolerimin e specifikuar ne lidhje me personin e trete;
- Per te llogaritur kohen per kryerjen e veprimit ose ndermarrjen e nje hapi per kryerjen e tij, data e cila do te merret si reference ne momentin e llogaritjes, ajo periudhe do te hiqet dhe nese ajo dite nuk eshte nje Dite Pune, afati do te perfundoje ne ditën pasardhese qe eshte Dite Pune;
- Çdo material bashkangjitur kesaj Marreveshje duke perfshire Aneksët perben nje pjese integrale te kesaj Marreveshje dhe çdo reference ne kete Marreveshje do te thote reference edhe ne materialet bashkangjitur, ne formen e aneksit apo ndonje forme tjetër. Gjithsesi



- Palet bien dakord kushtet tregtare dhe ligjore te percaktuara ne kete Marreveshje do te kene perparesi kundrejt kushteve te ngjashme te percaktuar ne Aneksa; dhe
- Nje reference tek nje Pale do te konsiderohet reference qe perfishin dhe pasardhesit e pranuar.

1.3 Konfliktet

Ne kete Marreveshje (duke perfshire Hyrjen dhe Aneksat), perveç rasteve kur konteksti kerkon ndryshe ose kur eshte specifikuar ndryshe ne vazhdim:

- 1.3.1 Ne rastin kur dispozitat e cilado dokumenti transaksioni jane ne mosperputhje me kete Marreveshje: (i) dispozitat e kesaj Marreveshje do te kene perparesi, dhe (ii) asnje Pale nuk do te gzoje te drejta ne baze te dispozites qe eshte ne mosperputhje me Marreveshjen.
- 1.3.2 Ne momentin qe dispozitat e ndonje Aneksi apo shtojce te kesaj Marreveshje jane ne mosperputhje me kete Marreveshje: (i) dispozitat e kesaj Marreveshje do te kene perparesi, dhe (ii) asnje Pale nuk do te gzoje te drejta ne baze te dispozites qe eshte ne mosperputhje me Marreveshjen.

2 OBJEKTI DHE QELLIMI I TRANSAKSIONIT

2.1 Shitja dhe Blerja e Aksioneve

Bazuar ne kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Marreveshje, Shitesi do t'i shesi dhe transferoje Bleresit Aksionet e "Birra Tirana" sha dhe Bleresi do te bleje dhe perfitoje Aksionet e "Birra Tirana" sha, per cmimin e percaktuar ne Nenin 3, i pagueshem ne menyren e pershkruar ne te.

2.2 Koha e Kalimit te Pronesise mbi Aksionet e "Birra Tirana" sha

Kalimi i pronesise mbi Aksionet e "Birra Tirana" sha nga Shitesi te Bleresi do te ndodhe ne Daten e pagimit te cmimit te plote te shitjes.

2.3 Transferimi i Pronesise te Aksioneve te "Birra Tirana" sha

Nese asgje nuk eshte ne kundërshtim me kete Marreveshje ose Dokumentet e Transaksionit:

- 2.3.1 Bleresi do te bleje ne Daten e Nenshkrimimit Aksionet e "Birra Tirana" sha, dhe
- 2.3.2 Bleresi do te behet pronar i Aksioneve te "Birra Tirana" sha dhe do te gzoje te drejten per te ushtruar te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga pronesia mbi Aksionet e "Birra Tirana" sha ne Daten e pagimit te cmimit te plote te shitjes dhe Shitesi nuk do te kete me pronesi, te drejte per dividend, dhe/ose te drejte vote dhe /ose çdo te drejte mbi Aksionet e "Birra Tirana" sha.

2.4 Mos aplikimi i te Drejtes se Parablerjes

- 2.4.1 Shitesi garanton Bleresin se aksionet qe ai zoteron te shoqeria "Birra Tirana" jane lirisht te transferueshme tek ortaket e saj, dhe se nuk ka nevojte te ushtroje te drejten e parablerjes tek ortaket e tjere te shoqerise "Birra Tirana" sha, bazuar ne parashikimin e nenit 26 te

Statutit të shoqërisë "Birra Tirana", të përfshirë këtu si Aneksi 2 (Statuti i shoqërisë "Birra Tirana" sh.a).



3 ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

3.1 ÇMIMI I BLERJES

- 3.1.1 Pagesa totale për Aksionet e "Birra Tirana" sh.a do të jetë e barasvlershme me EURO 1.800.000 (një milion e teteqindmijë Euro) dhe do të paguhet në një kësht të vetëm në Euro menjehere dhe në të njëjten date me disbursimin e kredisë nga "Banka e Tiranës" sh.a në llogari të Blerësit.
- 3.1.2 Çmimi i Blerjes nuk do të përfshijë regjistrimin ose tarifën për ndryshimin e pronësive, që do të mbulohej plotësisht nga Blerësi.

3.2 MENYRA E PAGESES PËR ÇMIMIN E BLERJES

- 3.2.1 Blerësi me qëllim pagimin e çmimit të blerjes prej EURO 1.800.000 (një milion e teteqind mijë Euro) ka aplikuar pranë "Banka e Tiranës" sh.a për të marrë financim/kredi.
- 3.2.2 Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje për Shitblerjen e Aksioneve, Blerësi do të paraqesë provë me shkrim nga "Banka e Tiranës" sh.a që kjo e fundit ka miratuar në favor të Blerësit një kredi me qëllim blerjen e aksioneve dhe pagimin e çmimit të blerjes objekt të kësaj kontrate.
- 3.2.3 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje për Shitblerjen e Aksioneve, Shitesit pranon të vendosë një barre siguroese dhe/ose peng mbi aksionet në shitje, objekt kontrate, në favor të "Banka e Tiranës" sh.a, me qëllim disbursimin e kredisë që do t'i jepet Blerësit nga kjo e fundit për pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve sipas kësaj Kontrate. Disbursimi i kredisë do të bëhet në llogarinë bankare të Blerësit me të dhënat si më poshtë:

MBAITESI I LLOGARISE: SHOQERIA "HYSENBELLIU" SHPK

BANKA E TIRANES SHA

NUMRI I LLOGARISE:

EUR_0110-300206-100

IBAN_AL47 2061 10 11 0000 1103 0020 6100

- 3.2.4 Çmimi i Shitjes nënkupton EURO 1.800.000 (një milion e teteqindmijë Euro) do të paguhet në një kësht të vetëm në Euro menjehere dhe në të njëjten date me disbursimin e kredisë në llogarinë bankare të Blerësit. Blerësi do të transferojë menjehere çmimin e shitjes në llogarinë e Shitesit me të dhënat si më poshtë:

Mbajtesit i Llogarise: Shoqeria "AL&GI" shpk

Banka e Tiranës sh.a



Numri i llogarise:

EUR _____

IBAN _____

3.2.5 Nese cmimi i shitjes nuk do te paguhet menjehere dhe ne te njejtën date me Daten e Disbursimit te kredise, barra dhe/ose pengu i vendosur mbi aksionet objekt shitje ne pronesi te Shitesit ne favor te "Banka e Tiranës" per te garantuar kredine e Bleresit, duhet te hiqet menjehere.

4 DATA E NENSHKRIMIT DHE KUSHTET

4.1 NENSHKRIMI

4.1.1 Ne Daten e Nenshkrimit, secila Pale duhet te kete pëmbushur të gjitha kushtet per te cilat ishte pergjegjese, *inter alia*, per Nenet 4.2.2 dhe 4.2.3

4.2 KUSHTET NE DATEN E NENSHKRIMIT

4.2.1 Ne Daten e Nenshkrimit, Shitesi do te:

1. dorezoje tek Bleresi ekstrakt nga regjistri tregtar kompetent ose regjistrat tregtare, vendime te shoqerive (nese kerkohet) prokura, qe vertetojne se Shitesi, Birra Tirana sha dhe perfaqesuesit e shitesit jane te autorizuar te nenshkruajne gjithe Dokumentet e Transaksionit ne te cilin jane pale;
2. te nenshkruaje dhe te dorezoje tek Bleresi, ne çdo forme, çdo dokument tjeter qe mund te kerkohet per regjistrimin e kalimit te Aksioneve te "Birra Tirana" sha nga Shitesi tek Bleresi;
3. te nenshkruaje rregullisht kete Marreveshje;

4.2.2 Ne Daten e Nenshkrimit, Bleresi do te:

1. dorezoje tek Shitesi ekstrakt nga regjistri tregtar kompetent ose regjistrat tregtare, vendime te shoqerive (nese kerkohet) prokura, qe vertetojne se Bleresi dhe perfaqesuesit e tij, jane te autorizuar te nenshkruajne gjithe Dokumentet e Transaksionit ne te cilin jane pale;
2. te nenshkruaje rregullisht kete Marreveshje;
3. ti sigurojë Shitesit provë me shkrim nga "Banka e Tiranës" sha. që kjo e fundit ka miratuar ne favor te Bleresit nje kredi me qellim blerjen e aksioneve dhe pagimin e cmimit të blerjes objekt te kesaj kontrate.

4.2.3 Gjithe veprimet ne Daten e e Disbursimit te Kredise, kalimi i Aksioneve te "Birra Tirana" sha dhe pagimi i Çmimit te Shitjes konsiderohen se jane kryer njekohesisht. Nese nje nga keto veprime nuk eshte kryer, gjithe veprimet e tjera do te quhen te pa realizuara dhe nenshkrimi do te konsiderohet i pa kryer dhe barra e vendosur nga ana e Banka tirane mbi aksionet ne shitje duhet te hiqet ne menyre te menjehershme .



5 KALIMI I AKSIONEVE

5.1 Ne Datën e pagimit të Çmimit të Shitjes, Blerësi do të bëhet pronar i Aksioneve të "Birra Tirana" sh.a dhe lejohet të ushtrojë gjithë të drejtat lidhur me to dhe që rrjedhin nga pronësia mbi Aksionet e "Birra Tirana" sh.a, dhe shitësi nuk do të ketë pronësi, të drejta për dividend dhe/ose të drejta vote, dhe/ose ndonjë të drejtë lidhur me këto aksione.

5.2 Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshje dhe çdo Dokumenti Transaksioni, e cila është e mundur të kryhet me pas por nuk është kryer deri në Datën e Nenshkrimit, duke përfshirë të gjitha përfaqësimet dhe garancitë ose detyrimet e paleve të përmbajtura ose të ndermarra sipas kësaj Marrëveshje, do të mbeten në fuqi të plota dhe do të kenë efekt pavarësisht Nenshkrimit.

6 KUSHTET PARAPRAKE TE NENSHKRIMIT

Detyrimi i Bleresit per te blere Aksionet e "Birra Tirana" sha dhe te paguaje Çmimin e Shitjes dhe detyrimi i Shitesit per te shitur dhe kaluar pronesine e Aksioneve te "Birra Tirana" sha te Bleresi, kushtezohen nga permbushja ose heqja dore, ne ose deri ne Daten e Nenshkrimit te Marreveshjes, por jo me vone se Data e Nenshkrimit te kushteve paraprake te percaktuara ne nenet 6.1, dhe 6.2 ("Kushtet") ne menyre te kenaqshme per Palet:

6.1 KUSHTET PARAPRAKE NEN PERGJEGJESINE E SHITESIT

Shitesit do te kryejne perpjekje te arsyeshme te sigurojne permbushjen e Kushteve si vijon:

Te gjitha garancite e Shitesit do te jene te sakta dhe te verteta gjithe elementet materiale ne Daten e Nenshkrimit, (pervec rasteve kur ngjarjet referohen nje date te caktuar ose per nje kohe te caktuar, e cila duhet te jete e vertete dhe e sakte vetem ne ate periudhe specifike kohore).

6.2 KUSHTET PARAPRAKE NE PERGJEGJESINE E BLERESIT

Bleresi do te kryejne perpjekje te arsyeshme te siguroje permbushjen e Kushteve si vijon:

- 6.1.1 Te gjitha autorizimet, miratimet, urdhrat ose aprovimet, depozitimet (nese ka), per te plotesuar blerjen dhe shitjen e Aksioneve te "Birra Tirana" sha, do te jene pergatitur dhe marre.
- 6.1.2 Te gjitha garancite e Bleresit do te jene te sakta dhe te verteta ne çdo aspekt material ne Daten e Nenshkrimit
- 6.1.3 Bleresi ka paraqitur prove me shkrim nga "Banka e Tiranës" sha që kjo e fundit ka miratuar ne favor te Bleresit nje kredi me qellim blerjen e aksioneve dhe pagimin e çmimit të blerjes objekt te kesaj kontrate. Bleresi deklaron dhe garanton se fondet per pagimin e Çmimit te Shitjes jane nga burime te ligjshme dhe do të sigurohet nëpërmjet financimit/kredisë që do të jepet nga "Banka e Tiranës" sha, pas depozitimit të kesaj Marreveshje për Shitblerje Aksionesh. Gjithashtu, Bleresi merr persiper qe te kryejte te gjitha procedurat dhe veprimet e nevojshme te kerkuara nga "Banka e Tiranës" sha me qellim permbushjen e kushteve te disbursimit te kredise.

6.2 MARREVESHJET E PERBASHKETA NE LIDHJE ME KUSHTET PARAPRAKE

Ne baze te termave dhe kushteve te parashikuar, Palet bien dakord te bashkepunojne dhe te bejne perpjekjet e tyre te arsyeshme per te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme, te duhura dhe te keshillueshme ne perputhje me ligjet e zbatueshme per te permbushur dhe per te bere me efektive Transaksionin sipas kesaj Marreveshjeje.

7 DEKLARATAT DHE GARANCITE

7.1 DEKLARATAT DHE GARANCITE E BLERESIT

Bleresi ben deklarata dhe garancite e meposhtme per Shitesin ne lidhje me veten e tij, ku secila prej tyre eshte e vertete, e sakte dhe jo çorientuese ne Daten e Nenshkrimit dhe duhet qe te jene te verteta, te perpikta dhe te sakta ne Daten e Nenshkrimit.

7.1.1 Organizimi



Bleresi është një shoqëri e të drejtës shoqërore, e organizuar rregullisht, themeluar në bazë të ligjeve të juridiksionit ku ndodhet selia e tij e regjistruar, nuk është në gjendje paaftësie paguese si dhe ka të drejtë të plotë për të kryer biznesin e tij siç është organizuar.

7.1.2 Autorizime

Te gjitha aktet e shoqërisë dhe/ose veprimet e tjera që kërkojnë të merren nga ose në emër të Bleresit për të autorizuar ato për të hyrë dhe për të zbatuar këto Marrveshje dhe Dokumentet e Transaksionit që Palët janë marrë dhe janë të vlefshme. Kjo Marrveshje është nënshkruar rregullisht dhe është dorëzuar nga Bleresi dhe përben një detyrim të vlefshëm të Bleresit në përputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara në të.

7.1.3 Gjendja financiare dhe aktiviteti i "Birra Tirana" sha

Bleresi deklaron se në Datën e Nënshkrimit të kësaj kontrate, është në dijeni të plotë të çdo informacioni lidhur me gjendjen financiare, ekonomike dhe tregtare të shoqërisë "Birra Tirana" sha, dhe se nuk ka asnjë pretendim as tani dhe as në të ardhmen lidhur me të drejtë dhe/ose detyrime të cilat mund të vijnë si pasoje e fitimit të Pronesise mbi Aksionet e "Birra Tirana" sha.

7.1.4 Permbushja e Kushteve Paraprake për Nënshkrimin

Bleresi dhe Shitesi duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për përmbushjen e Kushteve Paraprake për të cilat janë përgjegjës deri në Datën e Nënshkrimit.

7.1.5 Fondet

Bleresi do të ketë në Datën e Nënshkrimit provë me shkrim nga "Banka e Tiranës" sha që kjo e fundit ka miratuar në favor të Bleresit një kredi me qellim blerjen e aksioneve dhe pagimin e cmimit të blerjes objekt të kësaj kontrate.

7.2 DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITESIT

Shitesi deklaron dhe garanton që deklaratimet dhe çështjet të percaktuara në nenet 7.2.1 (*Organizimi*) deri dhe përfshirë nënen 7.2.4 (*Gjendja financiare dhe aktiviteti i "Birra Tirana" sha*) janë të vërteta, të sakta dhe jo çorientuese në Datën e Nënshkrimit.

7.2.1 Organizimi

Shoqëria "Birra Tirana" sha është një shoqëri ekzistuese e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe nuk është në gjendje paaftësie paguese apo falimentimi, nuk është subjekt likuidimi apo në procedurë prishjeje dhe ka kompetencën dhe autoritetin e plotë për të menaxhuar aktivitetin e shoqërisë dhe pronat e saj. Shoqëria "Birra Tirana" sha është pajisur me të gjitha licencat, lejet, autorizimet thelbësore dhe pelqimet e kerkuara për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria "Birra Tirana" sha operon në përputhje me ligjet e zbatueshme, me gjykimet, dekrete e çdo gjykate, komisioni apo çdo Autoriteti Shtetëror.

7.2.2 Autoriteti i për të hyrë në këto Marrveshjeje

Shitesi ka pushtetin dhe autoritetin e plotë për të zbatuar Marrveshjen dhe Dokumentet e Transaksionit në të cilën ai është palë, dhe përveç rasteve që parashikohet ndryshe, nuk është e



nevojshme per te kryer veprime te metajshme nga Shitesi per ta bere kete Marreveshje te vlefshme, te detyrueshme dhe te zbatueshme perkundrejt tij ne perputhje me afatet e parashikuar ne kete dokument. Per ekzekutimin dhe dorezimin e Marreveshjes ose kryerjen e detyrimeve te Shitesit ne vijim, nuk eshte e nevojshme per pelqimin, aprovimin, urdher, lejim ose autorizim, hecje dore, me deklarim ose njoftim te asnje Autoriteti Shteteror, pervec atyre qe ne menyre te qarte jane parashikuar ne kete Marreveshje.

7.2.3 Pronesia

- Shitesi eshte pronare i vetem, ligjore dhe perfitues i Aksioneve te "Birra Tirana" sha.
- Aksionet e "Birra Tirana" sha jane aksione te zakonshme, dhe paguar plotesisht.
- Aksionet e "Birra Tirana" sha jane te barresuara dhe/ ose te lena peng ne favor te Banka e Tiranës sha per te siguruar pagimin e kredive te marra nga z.Alban Xhaferi me Kontrate Kredie Bankare Nr.Co.632/16.04.2013 ne shumen EUR 1,000,000 (një milion euro) dhe me Kontrate Kredie Bankare Nr.Co.692/16.06.2014 ne shumen EUR 1,000,000 (një milion euro) dhe per kete Shitesi ka marre miratimin paraprak edhe te Banka e Tiranës sha per kalimin e pronesise se aksioneve te "Birra Tiranës" sha ne favor te Bleresit, te perfshire ketu si Aneksi 3

7.2.4 Gjendja financiare dhe aktiviteti i "Birra Tirana" sha

Te gjitha dokumentet ne lidhje me shoqerine "Birra Tirana" sha te kerkuar nga Bleresi jane vendosur ne dispozicion te Bleresit dhe asnje nga dokumentet thelbesore nuk i jane privuar Bleresit dhe veçanerisht te gjitha kopjet e dokumentacionit te bera disponueshme jane nje kopje e vertete e dokumentit origjinal dhe gjetjet reflektojne gjendjen e sakte te aktivitetit te shocerise "Birra Tirana" sha. Ne dijenine tone, nuk ka fakte ose çeshtje mungesa e te cilave ben çorientuese ndonje nga Garancite e Shitesit ose qe ne menyre te arsyeshme do te mund te ndikonte ne gjykimin e Bleresit ne lidhje me blerjen e Aksioneve te "Birra Tirana" sha sipas kushteve te kesaj Marreveshjeje.

8 **PRETENDIME PER DEMET**

8.1 **DETYRIMET E SHITESIT**

- 8.1.1 Shitesi nuk ka pergjegjesi per çfaredo shkak apo arsye kundrejt Bleresit dhe/ose paleve te treta dhe/ose institucioneve publike pas transferimit të pronësisë të aksioneve në emër të Blerësit. Çdo detyrim qe mund te linde ne te ardhmen pas transferimit të pronësisë të aksioneve në emër të Blerësit do te jete pergjegjesi e Bleresit.

8.2 **DETYRIMET E BLERESIT**

- 8.2.1 Bleresi do jete pergjegjes dhe duhet te mbaje te pademtuar Shitesin nga humbja qe mund t'i shkaktohet, dhe sipas rastit, duhet t'i behet me dije Shitesit ne rast se pas Dates se Nenshkrimit, do te lindin rrethana dhe fakte te reja nga çdo shkelje e Garancive te Bleresit ose te kesaj Marreveshjeje.



- 8.2.2 Çdo kompensim për Humbjet e pagueshme nga Bleresi duhet të paguhet në mënyrë proporcionale me numrin e Aksioneve të "Birta Tirana" sh.a që ai po blen.
- 8.2.3 Në lidhje me kete, është rënë dakord që mekanizmi sipas klauzoles 10.1.1 të 10.1.2 do aplikohet mutatis mutandis në atë masë që është e mundur.

9 ZGJIDHJA

9.1 SHKAKU I ZGJIDHJES DHE NJOFTIMI

- 9.1.1 Përveç rasteve kur Marreveshja parashikon ndryshe, marrëdhënia kontraktore midis Shitesit dhe Bleresit mund të zgjidhet në këto raste:
- Me marreveshje të përbashkët të shkruar nga Shitesi dhe Bleresi sipas datës të parashikuar aty;
 - Me zgjidhje të njëanshme nga njëra nga palët duke njoftuar me shkrim palën tjetër për zgjidhje, nëse Nenshkrimi nuk do të ndodhë, do të ketë efekt që nga dita e dorëzimit të njoftimit të perfundimit tek pala tjetër;
 - Me zgjidhje të njëanshme nga njëra nga palët duke njoftuar me shkrim palën tjetër për zgjidhje, nëse kushtet paraprake nuk do të përmbushen pas nenshkrimit deri në datën e Disbursimit të Kredisë, dhe/ose nëse nuk do të paguhet cmimi i shitjes në datën e Disbursimit të kredisë.

10 LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJET E MOSMARRVESHJEVE

Palët bien dakord që çdo mosmarreveshje (duke përfshirë çdo pretendim për dëm sipas kesaj Marreveshje) që ka lindur në lidhje me këtë Marreveshje duhet të zgjidhet në përputhje me parashikimet e Nenit 10.

10.1 LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marreveshje do të udhëhiqet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.


10.2 JURIDIKSIONI

Të gjitha mosmarreveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marreveshje do të zgjidhen në mënyrë perfundimtare nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, vendimet e ciles janë të ankimueshme sipas parashikimeve të kodit të procedurës civile.

11 TË NDRYSHME

11.1 FORCA MADHORE

- 11.1.1 Asnjë Palë nuk do të mbajë përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marreveshje për shkak të Forcës Madhore.
- 11.1.2 Në rast të Forcës Madhore, Pala që është penguar ose është vonuar në përmbushjen e detyrimeve të saj duhet të njoftoj palën tjetër pa hezitim, duke komunikuar për të gjitha



detajet e plota të Forcës Madhore si dhe arsytet përse pengohet Pala në përmbushje të detyrimit, ose vonesën e saj, Pala duhet që të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zbutur efektet e ngjarjes në mënyrë që të zbatohet Marrëveshja dhe detyrimet sipas Marrëveshjes.

- 11.1.3 Pas përfundimit të ngjarjes, Pala e prekur duhet sa më shpejt të jetë e arsyeshme të fillojë zbatimin/përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes.
- 11.1.4 Në rast se efektet e Forcës Madhore vazhdojnë për një periudhë prej 60 ditësh ose më shumë, secila nga Palet ka të drejtë për të kërkuar zgjidhjen e Marrëveshjes me efekt të menjehershëm duke njoftuar me shkrim.

11.2 NJOFTIME

Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera që kërkojnë ose mund të jepen në bazë të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë në mënyrë të rregullt nëse dorëzohen me postë elektronike, dorëzuar me dorë ose me postë, postë të klasat të parë, kur është dërguar me shërbimin e dërgimit të korrierit, në çdo rast të adresuar si me postë, ose në atë adresë tjetër që do të përcaktohet me anë të njoftimit të dhënë në mënyrë të rregullt:

Për shitësin shoqëria "AL&GI" shpk:

Adresa: Rr. "Deshmoret e 4 shkurtit", njesia administrative nr. 10, përballë kishës, pranë ILDKP, Tiranë, Shqipëri

adresa e postës elektronike: algi.shpk@yahoo.com

Për Blerësin Shoqëria "Hysenbelliu" shpk,

Rruga "Panorama", pranë Hotel "Prestige", Tiranë, Shqipëri

Adresa e postës elektronike: office@hysenbelliugroup.com

Për Shitësin ose Blerësin do të përdoren adresat e treguara në këtë Marrëveshjeje në seksionin ku identifikohen Palet, ose në adresat e tjera të përcaktuara me shkrim nga secila nga Palet.

11.3 MARREVEESHJA E PLOTE / NDRYSHIMET

Kjo Marrëveshjeje përben të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjetet e mëparshme, me gojë ose shkrim, mes palëve në lidhje me thelbin e saj dhe mund të jetë e ndryshueshme vetëm me akt të nënshkruar nga secila Palë.

11.4 KALIMI

Asnjëra nga Palet nuk do të ketë të drejtë të kalojë ose transferojë të drejtat, përfitimet ose detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje pa një pëlqim paraprak me shkrim të Palës tjetër.



11.5 EFEKTI DETYRUES

Kjo Marreveshje do te jete detyruese per Palet dhe pasardhesit e tyre perkates dhe palet ku kalimi i te drejtave eshte tejuar.

11.6 NDASHMERIA

Nese nje dispozite e kesaj Marreveshje eshte e paligjshme, e pazbatueshme, duhet te modifikohet me minimumin e mases se nevojshme per ta bere ate te vlefshme, te ligjshme, te zbatueshme, ose nese modifikimi nuk eshte i mundur te behet, atehere dispozita te tilla do te bien nga kjo Marreveshje dhe dispozitat e tjera te Marreveshjes do mbeten ne fuqi.

11.7 MJETE TE TJERA

Mos ushtrimi ose vonesa per te ushtruar nje te drejte ose mjete juridike te ofruar nga kjo Marreveshje ose nga ligji nuk perben heqje dore nga nje e drejte tjeter ose mjete tjeter juridik, apo nga te drejtat te tjera ose mjetet juridike te tjera. Ushtrimi pjesor i nje te drejte apo mjete te percaktuar nga kjo Marreveshje apo ligji parandalon ushtrimin ne te ardhmen te se drejtes apo mjetit per te ushtruar nje te drejte apo mjet tjeter.

11.8 HEQJE DORE

Ne rast se njera nga palet nuk ushtron ose ka vonese ne ushtrimin e nje te drejte, kompetence ose mjetet juridike ne lidhje me kontraten (çdo e "drejte") nuk do te konsiderohet si heqje dore, si dhe ushtrim i vetem ose i pjesshem i kesaj te drejte nuk perjashton ushtrim te metejshem te kesaj te drejte ose te nje te drejte tjeter. Te drejtat e parashikuar ne kete marreveshje jane kumulative dhe nuk perjashtojne te drejta te tjera (qofte te parashikuar me ligj ose ndryshe). Çdo heqje dore e shprehur per shkelje se Marreveshjes nuk do te konsiderohet si heqje dore e shkeljeve te mevonshme.

11.9 KOSTOT DHE TAKSAT

Pervecse kur Marreveshja parashikon ndryshe, secila nga Palet duhet te pagoje kostot lidhur me negocimin dhe pergatitjen e kesaj Marreveshje dhe çdo aneks te saj. Çdo ose te gjltha kostot e regjistrimit te Bleresit si mbajtes dhe pronar i Aksioneve te "Birra Tirana" sha prane ndonje autoriteti qeveritar do te perballohen nga Bleresi.

11.10 KONFIDENCIALITETI

Ne perputhje me kete Marreveshje, secili nga Shitesi dhe Bleresi nuk duhet te bejne me dije Informacione Konfidenciale paleve te treta pa marre nje miratim paraprak te shkruar nga pala tjeter. Detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet per informacionet konfidenciale qe i behen me dije organeve menaxhuese te Bleresit, punemarresve, drejtoreve, keshilltareve ose agjenteve te pales ne nevojte per te njohur bazen, me kusht qe pala tjeter ne çdo rast do te mbaje pergjegjesi per çdo shkelje te detyrimeve sipas klauzoles. Pavec kesaj, detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet ne rast se Pales i kerkohet sipas ligjit te zbatueshem, ose vendimi gjyqesor dhe administrativ qe te bej te ditur Informacionin paleve te treta. Sidoqofte ne keto raste vetem ne mases e parashikuar nga ligji i zbatueshem, vendimi gjyqesor ose

administrative do te behet me dije. Me perjashtim te parashikimeve te mesiperme, çdo pale duhet jap çdo Informacion Konfidencial Autoriteteve Qeveritare/Shteterore ne Shqiperi dhe çdo juridiksioni dhe Juridiksioneve perkatese per aq sa eshte e nevojshme, arsyeshme per te permbushur kushtet paraprake dhe ose detyrimet te tjera te permbajtura ne Marreveshjen.

11.11 GJUHA DHE KOPIJET

Kjo Kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe.

Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 ekzemplare, te cilat, te gjitha se bashku perbejne Kontrate te vetme te detyrueshme.

Palet

Shitesi

Shoqeria "AL&GI" Shpk

Perfaqesuar nga Z. Alban Xhaferi



Bleresi

Shoqeria "Hysenbelliu" Shpk

Perfaqesuar nga Znj. Arta Sino



NOTERI
NOTERE
EDLIRA S. HYSENI
069 26 74 797





- ANEKSI 1:** Autorizimet e Bleresit dhe te Shitesit
- ANEKSI 2** Statuti i Shoqerise "Birra Tirana" sha
- ANEKSI 3** Dokumentacioni mbi kredine e dhene nga Banka e Tiranës sha


VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE
SHOQERISE "AL&GI" SH.P.K
TIRANE

Sot, me date 16.12.2019, ora 10.30 ne seline e shoqerise "AL&GI" Sh.p.k, u mbajt mbledhja e Asamblese se Ortakeve te shoqerise.

Jane te pranishem ne mbledhje ortaket si me poshte:

1. **Z. Alban Xhaferi**, shtetas shqiptar, i biri i Ejupit, lindur me 07.04.1970, ne Shijak, Durrës dhe banues në Tiranë, në adresën, Rr. "Dervish Hima", Pallatet Al&GI shk 1 kt 11 Tirane, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. 030174426, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i cili zoteron 99.9 % te kapitalit te shoqerise.
2. **Shoqeria « Hysenbelliu » shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me nr NIP1 J81813004C, me seli në adresën: rruga "Panorama", pranë Hotel "Prestige", përfaqësuar nga Administratori, Znj. Arta Sino, shoqeri qe zoteron 0.1 % te kapitalit te shoqerise.

Mbledhja kryesohe: nga administratori i shoqerise Z. Alban Xhaferi.

Kryetari i Mbledhjes pasi konstatoi se kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte realizuar, e deklaroi ate te hapur dhe i beri te ditur ortakeve rendin e dites si me poshte:

1. Miratimi i shitjes se 19.48 % te aksioneve qe shoqeria "AL&GI" Sh.p.k zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha, sipas kushteve dhe cmimit te rena dakort mes paleve.
2. Miratimi i nenshkrimimit te kontrates se shit-blerjes se aksioneve mes shoqerise "AL&GI" shpk ne cilesine e shitesit dhe shoqerise "Hysenbelliu" shpk ne cilesine e blesesit.
3. Autorizimin e administratorit te shoqerise "AL&GI" shpk Z. Alban Xhaferi qe te nenshkruaje ne emer dhe per llogari te shoqerise kontraten e shitblerjes se 19.48 % te aksioneve qe shoqeria "AL&GI" Sh.p.k zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha.

Kryetari i mbledhjes i beri me dije ortakeve se ne kushtet kur kerkohej te diskutohet dhe te miratohet nje kontrate mes shoqerise dhe njerit prej ortakeve



te shoqerise, konkretisht ortakut "Hysenbelliu" shpk, atehere ky ortak nuk mund te marri pjese ne votim dhe nuk ka te drejte vote. Ortaku tjetër i shoqerise qe perfaqeson pjesen me te madhe te kapitalit te shoqerise, pasi u njoh me rendin e dites per te cilin trerkua votimi i tij,

VENDOSI:

1. Miratimin e shitjes se 19.48 % te aksioneve qe shoqeria "AL&GI" Sh.p.k zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha, sipas kushteve dhe cmimit te rena dakort mes paleve.
2. Miratimi i nenshkrimit te kontrates se shit-blerjes se aksioneve mes shoqerise "AL&GI" shpk ne cilesine e shitesit dhe shoqerise "Hysenbelliu" shpk ne cilesine e blesesit.
3. Autorizimin e administratorit te shoqerise "AL&GI" shpk Z. Alban Xhaferi qe te nenshkruaje ne emer dhe per llogari te shoqerise kontraten e shitblerjes se 19.48 % te aksioneve qe shoqeria "AL&GI" Sh.p.k zoteron ne kapitalin e shoqerise "Birra Tirana" sha.
4. Rregjistrimin e ketij vendimi dhe kontrates se shit-blerjes se aksioneve ne Qendren Kombetare te Biznesit;

* * *

Duke mos patur ceshtje tjeter per te diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaroi ate te mbyllur ne oren 11.00.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "AL & GI" SH.P.K

Z.Alban Xhaferi




 REPUBLIKA E SHqipërisë
 MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
 QENDRA KOMETARE E BIZNESIT



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”


GJENDJA E REGJISTRIMIT



1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	J82020004P	
2. Data e Regjistrimit	30/07/1997	
3. Emri i Subjektit	AL & GI	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	21/07/1997	
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/07/1997 Deri:	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, perballe Kishes, prane ILDKP	
8. Kapitali	167.200.000,000	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,000	
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e ndertimeve civile, industriale etj. Reklamave. Ndertime civile industriale, ushtarake, hotele, banesa, ujesjellesa, kanalizime, import eksport te mallrave e materialeve te ndertimit, bar kafe, ambjent shplodhes. Denie me qera.	
10. Administratori/ët	Alban Xhaferi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 25/05/2016	Deri: 25/05/2021
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Alban Xhaferi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 167.032.800,000	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,000	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	99,900	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT



12.4	Komente (nëse ka)		
13.	Ortakët	HYSENBELLIU	
13.1	Vlera e kapitalit	Para: 167.200,000	Natyre:
13.2	Numri i pjesëve	1,000	
13.3	Pjesëmarrja në përqindje (%)	,100	
13.6	Komente (nëse ka)		
14.	Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Vaqarr SHARRE Fshati Sharre, perballe karburant Volvoil Tirane Tirane TIRANE Automjet furgon Mercedes Benz me targë TR 4982 K Tirane Tirane TIRANE Autorajet kamion Mercedes Benz me targë TR 5893 K Tirane Tirane TIRANE Automjet Mitsubishi L200 me targë TR 2541 J.	
15.	Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: AL & GI E-Mail: algicompany@yahoo.com Telefon: 2233993 Të Tjera: Dorezim i bilancit te vitit 2007. Pasqyrimi ne historikun e veprimeve te kryera, te miratimit te aplikimit sipas Vertetimit te Kryerjes se Rregjistrimeve te tjera date 08-10-2008 dhe Vertetimit te Kryerjes se Regjistrimeve te tjera date 31-10-2008, per perfundimin e procesit te bashkimit me perthithje te shoqerise "AL & GI" sh.p.k me nipt J82020004P (shoqeria perthithese) dhe shoqerise "METROPOL -ALB" sh.p.k me nipt K41902008C (shoqeria e perthithur). Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise "METROPOL-ALB" sh.p.k, kalojne ne favor te shoqerise "AL & GI " Sh.p.k. Shoqeria qe perthithet "METROPOL-ALB" sh.p.k.vleresohet e prishur pa likujdim, duke kaluar ne statusin e " Çregjistruar". Depozitimi i vendimit date 03-11-2009. Depozitimi i Marreveshjes Siguruese Nr. 3944 Rep. Nr. 1375 Kol. date 09-11-2009 me pale: Barredhënesi: "AL&GI" sh.p.k Barremarresi: "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a. Depozitimi i Kontrates Kredi me kufi Nr. 3943 Rep. Nr. 1374 Kol. date 09-11-2009.	
16.	Statusi:	Aktiv	



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMITETARE E BIZNESIT



Data: 16-12-2019

ORONGA M. MURZUKE
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



"HYSENBELLIU" SHPK
RRUGA "PANORAMA", PRANË HOTEL PRESTIGE
KODI POSTAR 1016, NJËSIA BASHKIAKE NR.9, TIRANË



VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 11.12.2019, ora 10:30, në adresën e selisë të shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k me selinë në Rruga "Panorama" Kulla e Biznesit, Kod Postar 1016, Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar më 11.06.1998, me NIPT J81813004C (më poshtë referuar si "shoqëria").

Në mbledhje mori pjesë ortaku i vetëm:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë

Ortaku i vetëm deklaroi se Asambleja e Përgjithshme edhe pse nuk është njoftuar paraprakisht, bazuar në nenin 83/2 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Miratimin e blerjes së 19,48 % të kapitalit themeltar që shoqëria "AL & GI" shpk me NIPT J82020004P zotëron pranë shoqërisë "Birra Tirana" sh.a, me cmim shitje 1.500.000 (një milion e tetëqind mijë) Euro nga ana e "Hysenbelliu" shpk, sipas termave dhe kushteve të Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve që do të nënshkruhet mes palëve;
2. Autorizimin e administratorit të shoqërisë znj. Arta Sinc të nënshkruajë çdo akt të nevojshëm për blerjen e 19.48 % të kapitalit themeltar që shoqëria "AL & GI" shpk zotëron pranë shoqërisë "Birra Tirana" sh.a.

Ortaku prezantoi në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të statutit të shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

"HYSENBELLIU" SHPK
RRUGA "PANORAMA", PRANË HOTEL PRESTIGE
KODI POSTAR 1016, NJËSIA BASHKIAKE NR.9, TIRANË

Për sa më sipër:

ASAMBLEJA E SHOQËRISË
VENDOSI:

1. Të miratojë blerjen e 19,48 % të kapitalit themeltar që shoqëria "AL & GI" shpk me NIPT J32020004P zotëron pranë shoqërisë "Birra Tirana" sh.a, me cmim shtjje 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) Euro nga ana e "Hysenbelliu" shpk, sipas termave dhe kushteve të Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve që do të nënshkruhet mes paëve;
2. Të autorizojë administratorin e shoqërisë znj. Arta Sino të nënshkruajë çdo akt të nevojshëm për blerjen e 19.48 % të kapitalit themeltar që shoqëria "AL & GI" shpk zotëron pranë shoqërisë "Birra Tirana" sh.a.

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

ORTAKU I VETËM
Z. IRFAN HYSENBELLIU






SHOQËRISË ANONIME PA OFERTE PUBLIKE "BIRRA TIRANA" SH.A.

Aksioneret e shoqërisë kanë vendosur perpilimin dhe pershtatjen e statutit të shoqërisë "Birra Tirana" sh.a. në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 1 EMERTIMI DHE STATUSI LIGJOR

Emertimi i shoqërisë është "BIRRA TIRANA" SH.A. (me poshtë referuar si "Shoqëria"), ajo është një person juridik i organizuar në formën e një shoqërie anonime pa oferte publike. Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetes të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

NENI 2 SELIA

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Kavajes", Tirane, Shqipëri**. Për të ushtruar aktivitetin e saj dhe për qëllime të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Emri dhe logo janë pronë e shoqërisë.

NENI 3 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është pa limit dhe ka filluar aktivitetin që nga regjistrimi i saj me datë 02.09.1998 me vendimin nr. 19966 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 4 OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Prodhimi dhe tregtimi i birrës për tregun e brendshëm dhe të jashtëm.
- Importimi, blerja dhe shitja e lendeve të para dhe ndihmese për prodhimin e birrës.





- Importimi, blerja dhe shitja e ambalazheve për ambalazhimin e birres dhe promovimin e shitjes së saj.
- Prodhimi, importimi, blerja dhe shitja e gazit karbonik.
- Kryerja e të gjitha operacioneve dhe veprimtarive tregtare, industriale, investuese dhe financiare që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe që janë të nevojshme për realizimin e objektit të mesipër të veprimtarisë së Shoqërisë.
- Hapja e veprimtarive dhe krijimi i shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

**NENI 5
AKSIONERET DHE KAPITALI**

Kapitali i shoqërisë është 1.110.550.000 (njemilardë e njëqind e dhjetë milione e pesëqind e pesëdhjetë mijë) leke e ndarë në 1.110.550 (njemilion e njëqind e dhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) aksione, me një vlerë nominale 1000 leke (njemijë leke) secili aksion.

Një aksion i shoqërisë mund të zotërohet nga një apo më shumë persona. Personat që zotërojnë në mënyrë të përbashkët një aksion, me marrëdhënie me shoqërinë, ushtrojnë të drejtat e aksionarit, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet, që rrjedhin nga zotërimi i aksionit. Vpërdoret e shoqërisë ndaj aksionit të zotëruar nga më shumë persona krijojnë pasojë ndaj të gjithë zotëruarëve të tij, edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej tyre.

Aksionerë e shoqërisë janë personat të cilët rezultojnë të regjistruar në regjistrin e aksioneve dhe në regjistrin e e Qendros Kombëtare të Regjistrimit dhe ata kanë të drejta të plota si për marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu edhe ndaj të tjerëve.

**NENI 6
PARIMET**

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji për shoqëritë tregtare ose nga statuti, në rrethana të njëjta, aksionarët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Sa më sipër përjashton shprehimisht të drejtat e lidhura me aksionet të cilat për të menjanaur çdo dyshim janë në përputhje me aksionet e zotëruara në shoqëri

(Handwritten signatures)





Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë

1. Aksionarët e shoqërisë tregtare, dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës apo administratorët, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dëjani për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përcmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

2. Cdo aksioner mbart detyrimin që të deklarojë pjesëmarrjen e tij në aktivitete të tjera tregtare apo dytësore që kanë të bëjnë me prodhimin e birres për të shmangur cdo lloj konflikti interesi në këtë fushë.

Neni 8

Ndalimi i konkurrencës

1. Administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të një shoqërie aksionare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera të cilat ushtrojnë veprimtari në sektorin e prodhimit të birres brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në sektorin e prodhimit të birres.

2. Asambleja e përgjithshme mund të shfuqizojë ndalimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, me tre të katërtat e votave.

3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:

- të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;

c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes.

Neni 9 Sekreti tregtar

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.

2. Administratori apo anetaret e këshillit mbikëqyrës, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet të ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes.

NENI 10

Emertimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e përfaqësuesve të shoqërisë duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të treta. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Te gjitha shkresat, formularet apo çdo dokument tjetër korespondence, nxjerre nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letres ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen paleve të treta, duhet të përmbajne të dhënat e mëposhtme:

- a) - numrin unik të identifikimit;
- b) - formën ligjore të shoqërisë;
- c) - vendodhjen e selisë së regjistruar dhe zyrës qendrore të saj;
- d) - të dhënat relative nëse shoqëria është në likuidim.

NENI 11 STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQËRISE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerve.
2. Këshilli Mbikëqyrës.
3. Administratori.





ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONEREVE

Organi kryesor vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Aksionereve (me poshtë referuar si "Asambleja e Përgjithshme"), e cila përbëhet prej gjithë aksionereve të Shoqërisë. Kompetencat e Asamblese përfshijnë të gjitha kompetencat që i jep asaj Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

1. Përcaktimi i politikave kryesore tregtare;
2. Shtesa dhe ndryshime në statut;
3. Emerimi dhe shkarkimi i anetareve të Keshillit Mbikqytres;
4. Zgjedhja dhe shkarkimi i likuidatoreve dhe ekspertëve kontabël të pavarur;
5. Vendosja e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 3 dhe 4;
6. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të punës;
7. Miraton kostot e prodhimit të produktit objekt statuti
8. Shpërndarja e fitimeve vjetore;
9. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
10. Pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
11. Ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
12. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
13. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
14. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
15. Miraton strukturën e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë dhe strukturën e pagave me fondin e saj;
16. Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji për shoqëritë tregtare apo nga ky statut.
17. Krijimi i shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit

Asambleja e përgjithshme merr vendim në lidhje me pikat 6, 7 dhe 8 pas marrjes së dokumenteve përkatës, bashkë me raportin e administratorit, ose të keshillit mbikqytres dhe raportin e auditorit.

NENI 13 MBLEDHJET E ASAMBLESE

Asambleja e përgjithshme mbledhet në një mbledhje vjetore në të cilën thirren të të gjithë aksionerët në selinë zyrtare në Tiranë, Shqipëri, ose në vend tjetër e vendosur mbi vendimin unanimit të aksionereve, të paktën një herë në vit. Mbledhja mund të thirret nga

administratori, anetaret e keshillit mbikqyres dhe aksioneret qe perfaqesojne 5% ose me te vogel se 5%, te kapitalit sipas formes se percaktuar nga ligji.

Asambleja e pergjithshme duhet thirrur brenda 3 muajsh kur humbjet arrijne deri ne 1% te kapitalit fillestar dhe kur keto humbje jane te regjistruara ne bilancin vjetor ose ne raportet financiare te ndermjetme.

Asambleja e Pergjithshme duhet thirrur kur shoqeria propozon te shese apo te bleje asete te cilat kane nje vlere me te madhe se 5% nga vlera e pergjithshme e aseteteve te shoqerise.

NENI 14

RREGULLAT PER THIRRJEN E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Njoftimi per mbledhjen e asamblese ne te cilen permenden, pikat e rendit te dites, koha dhe vendi ku do te mbahet mbledhja, duhet te kryhet nepermejt nje njoftimi te shkruar, apo nepermejt postes elektronike (email) ne adresen e cdo aksioneri me te drejte vote, ose ne nje gazete te perditshme me shperndarje ne te gjithe vendin jo me pak se 21 dite perpara dites se mbledhjes.

Njoftimi duhet te permbaje:

- a) Emrin e shoqerise, seline, oren dhe daten e mbledhjes.
- b) Nje shpjegim te detajuar te procedurave qe do te ndiqen nga aksioneret ne menyre qe te marrin pjese ne te.
- c) Nje informacion lidhur me te gjitha format me ane te te cilave do te plotesohen dhe do te hyjne ne fuqi Projekt-vendimet.
- d) Lajmerimi per thirrjen e asamblese mund te publikohet edhe ne faqen zyrtare te internetit te shoqerise me te gjitha detajet e lartpermendura.

Rendi i dites duhet te perfshije vendimet e propozuara, dhe ne rastet e ndryshimeve te rendesishme ne statut, pambajtjen e sakte te ndryshimeve.

Kur Asambleja nuk thirret ne formen e lartpermendur, mund te merren vendime te vlefshme vetem ne rast pjesmarrije te te gjitha aksionereve te shoqerise te cilet shprehin deshiren e tyre per te marre vendime pavaresisht parrregullsise se konstatuar ne thirrjen e asamblese.

Neni 15

Përfaqësimi në asamble

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.





2. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

3 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

NENI 16

Pjesëmarrja ne mbledhjen e Asamblese se pergjithshme

Gjate mbledhjes se asamblese se pergjithshme pergatitet lista e aksionereve te pranishem dhe te perfaqesuesve te tyre, ku shenohen emrat dhe adresat e secilit, se bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave qe keto aksione japin, vleren nominale te aksioneve si edhe llojin apo kategorine e tyre te zotruara nga secili pjesemarrës. Kjo liste nenshkruset prej te pranishmeve.

Mbledhja e asamblese si rregull drejtohet nga nje kryetar, rolin e te cilit e luan Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne pamundesi te tij nga nen/Kryetari i Keshillit Mbikqyres.

Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te rregjistrohen ne procesverbal. Administratori eshte pergjegjes per ruajtjen e tyre.

Procesverbali duhet te mbaje te dhenat si: daten e mbledhjes, vendin, rendin e dites, emrin e kryetarit dhe te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qendrimet e mbajtura ne lidhje me vendimmarrjen nga kryetari dhe aksioneret. Procesverbalit i bashkelidhen lista e pjesmarrësve dhe dhe dokumentacioni i thirrjes se asamblese se pergjithshme. Procesverbali nenshkruset nga kryetari i mbledhjes dhe mbajtesi i procesverbalit.

NENI 17

KUORUMI DHE VENDIMARRJA NE MBLEDHJE

Ne mbledhjet e asamblese aksioneret mund te marrin pjese personalisht ose te perfaqesohen me autorizim apo prokure nga nje aksionar tjetër apo nga ne person i tretë. Administratori dhe anetaret e keshillit te administrimit nuk mund te veprojne si perfaqesues te aksionareve ne asamblene e pergjithshme.

- Ne rastin e ceshtjeve qe vendosen me shumice te zakonshme, asambleja merr vendime te vlefshme, vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar aksioneret qe zoterojne te pakten 50% te aksioneve ne mbledhjen e pare dhe ky kuorum bie ne 30% ne mbledhjen e dyte, nqs nuk arrihet kuorumi i mbledhjes se pare me kusht qe mbledhja e dyte te zhvillohet me te njejtin rend dite jo me vone se 30 dite nga mbledhja e pare.
- Per ceshtjet te cilat kerkojne nje shumice te kualifikuar, vendimi mund te jete i vlefshem vetem kur jane prezent ose te perfaqesuar te pakten 50% e aksionereve me te drejte vote.





- Në rastet kur kuorumi nuk është vendosur, mbledhja mund të shtyhet në një datë jo më vonë, se 30 dite nga data fillestare e mbledhjes.
- Shumica e kualifikuar nevojitet për çështje të cilat lidhen me: ndryshime në statut, rritja ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, riorganizimi ose prishja e shoqërisë, shpërndarja e fitimit, Krijimi i shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Pjesëmarrja mund të jetë nepermjet pranisë fizike, formsë shkresore, apo me anë të mjeteve të telekomunikimit që mundësojnë kryerjen e procesit të votimit në kohë reale.
- Për çështjet që vendoset me shumicë të zakonshme, asambleja merr vendime të vlefshme, me shumicën e votave të aksionereve që marrin pjesë në mbledhje, ndërsa për çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja merr vendime të vlefshme me të paktën tre të katërtat e votave të aksionereve që marrin pjesë në votim.

Cdo aksioner i zakonshëm përfaqëson një votë në procesin e votimit.

Per emerimin dhe shkarkimin e administratorit ose të anëtarëve të keshillit mbikqyres, asambleja e pergjithshme, vendos me votim të fshehte nese kjo menyre votimi kerkohet nga aksioneret, te cilet zoterojne nje numer aksionesh, qe perfaqesojne te paktën 5% te kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Per cdo çështje tjetër asambleja merr vendime nepermjet votimit të hapur.

NENI 18 KESHILLI MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres perbehet nga 8 anetare, te cilet jane persona fizike dhe numri i anetareve te keshillit nuk mund te kaloje asnjehere 21 persona. Shumica e anetareve te keshillit perbehet nga persona te pavarur qe nuk kryejne funksione administrimi.

Anetaret e keshillit mbikqyres zgjidhen nga mbledhja e asamblese se pergjithshme me shumicen e votave te aksionereve qe marrin pjesë në mbledhje, për një periudhë prej 3 vjetësh, me mundësi ri-emerimi.

Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i keshillit mbikqyres, nëse ai, njëkohësisht është:

- a) anëtar i keshillit mbikqyres në 2 shoqëri të tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;
- c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të keshillit mbikqyres, një anëtar të keshillit mbikqyres të shoqërisë së parë.
- d) është administrator i shoqërisë;
- e) është ortak apo anëtar i Këshillit Mbikqyres apo drejtues në një shoqëri aksionere që



ushtron veprimtari në sektorin e prodhimit të birres;

f) Cdo person që ushtron veprimtarinë e tregtarisë në sektorin e prodhimit të birres.

Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këtë pikë të këtij neni, është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e palëve të treta mbrohen sipas nenet 12 të ligjit për shoqëritë tregtare.

Anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit mbikëqyrës, detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

Keshilli Mbikëqyrës ka keto kompetenca.

1. Miratimi i akteve dhe rregulloreve të brendshme të shoqërisë dhe shtesat e ndryshimet në to;
2. Monitorimi dhe mbikëqyrja e vënies në zbatim të politikave tregtare nga administratori përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të punës;
3. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, kriteret për zgjedhshmërinë në këtë detyrë dhe masën e shpërblimit të tij
4. Marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të vlerës së aseteve të shoqërisë që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare nëpërmjet huave, ose emetimit të obligacioneveose instrumenteve të tjera të borxhit
5. Miraton kontratat që shoqëria mund të lidhë me të tretët, kur shuma vjetore e të gjithave kontratave bashkë e kalon vlerën prej 3 milion lekë
6. Dhënia e direktivave për drejtorët menaxhues në lidhje me vënien në zbatim të politikave tregtare;
7. Keshilli Mbikëqyrës ka të drejte të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që i cmon të pershtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshem për përmbushjen e detyres së tij;
8. Me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, përgatitja e masave të cilat bien në kompetencën e kësaj të fundit, rekomandimi i vendimeve për miratim nga asambleja e përgjithshme dhe vënia në zbatim e vendimeve të kësaj të fundit;
9. Thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nëse është i nevojshëm për interesat e shoqërisë tregtare;
10. Kujdesi që shoqëria tregtare respekton ligjin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
11. Shqyrtimi i librave, dokumenteve dhe aktiveve të shoqërisë tregtare;
12. Kujdesi që pasqyrat financiare vjetore të përgatiten nga Administratori si edhe raporti i tyre në lidhje me gjendjen dhe rezultatet e shoqërisë tregtare dhe të gjitha shpjegimet dhe informacionet e tjera që kërkon ligji ose statuti; këto

[Handwritten signatures and names]





dokumente duhet të miratohen dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e keshillit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme së bashku me një raport të keshillit për arsyet e miratimit dhe një përshkrim se si është monitoruar menaxhimi gjatë gjithë vitit të punës;

13. Kujdesi që të bëhet auditimi i librave dhe i regjistrave të paktën një herë në vit nga një auditues i pavarur, së bashku me raportin e audituesit për asamblesën e përgjithshme të aksionarëve, që u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të keshillit mbikqyres dhe administratorit. Raporti i keshillit i përmendur në pikën 12 përmban edhe mendimin për raportin e audituesit;

14. Keshilli Mbikqyres i propozon asamblese se aksionerëve lidhur me këto çështje:

- a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate të shoqërisë.
- b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- c) Hapjen e veprimtarive ose njesive të tjera si dhe ndryshimin e objektivit të shoqërisë
- d) Shitjen e pasurive që përbejnë aktivitetin e qendrueshëm të shoqërisë.
- e) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.
- f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjate.

15. Caktimin e një apo më shumë Revizorëve të Brendshëm të shoqërisë dhe masën e shpërblimit të tyre;


16. Krijimin e komisioneve ad-hoc për kontrollin e aktiviteteve të vecanta të shoqërisë

Anëtarët e keshillit mbikqyres që nuk marrin pjesë në mbledhjet e keshillit mbikqyres 3 here rradhazi shkarkohen dhe zëvendësohen me një kandidaturë tjetër.

Nuk aplikohet kjo dispozitë vetëm kur Asambleja e Aksionerëve ka marrë një vendim të vecantë për këtë problem me anën e të cilit ka vendosur që ky anëtar duhet të vazhdojë të jetë anëtar i keshillit mbikqyres pasi ai ka patur arsye të forta dhe bindese që ka munguar tre here rresht në mbledhjet e keshillit mbikqyres.

Për çdo mbledhje të munguar me ose pa arsye, anëtarët e keshillit mbikqyres që do të mungojnë në zhvillimin e këtyre mbledhjeve nuk do të paguhet. Shpërblimi që nuk do të përfitohet nga mospjesëmarrja në këto mbledhje, do të llogaritet duke pjesëtuar shpërblimin mujor fikse të miratuar për çdo anëtar të keshillit mbikqyres nga Asambleja e Aksionerëve, me numrin e mbledhjeve të cilat janë zhvilluar gjatë një muaji dhe anëtari ka marrë dijeni për to. Ky keshill do të zgjedhë ndërmjet anëtarëve të tij, një Kryetar dhe një Nenkryetar.

[Handwritten signatures and stamps]





NENI 19
EMERIMI I ANETAREVE TE PARE TE KESHILLIT MBIKQYRES


Ne baze te ligjit nr.9901, dated 14.04.2008, si dhe ndryshimet e tjera, per periudhen e pare prej 3 vjetesh, anetaret e keshillit mbikqyres jane si me poshte:

- **Z.Luan Bregasi**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 19.02.1956, i identifikuar me karte identiteti nr. 029947354, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e Kryetarit te Keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Z.Arben Selmani**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 01.06.1963, i identifikuar me karte identiteti nr. 027968935, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e Nenkryetarit te Keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Zj.Shefikat Ngjela**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 07.02.1956, i identifikuar me karte identiteti nr. 024935705, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetarit te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Znj. Aferdita Koni**, lindur e banuese ne Tirane, e datelindjes 23.04.1955, e identifikuar me karte identiteti nr. 029820329, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetaris te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Z. Adrian Doci**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 20.06.1965, i identifikuar me karte identiteti nr. 029809071, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetarit te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Z.Hari Lena**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 26.05.1961, i identifikuar me karte identiteti nr. 028236102, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetarit te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Z.Petrit Ago**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 12.12.1955, i identifikuar me karte identiteti nr. S 000 1715, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetarit te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.
- **Z. Aurel Pepa**, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 08.10.1973, i identifikuar me karte identiteti nr. 030110361, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, do te jete ne cilesine e anetarit te keshillit mbikqyres, dhe afati i qendrimit ne detyre do te jete 3 vjet me te drejte rizgjedhje.









NENI 20
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Aktiviteti i shoqërisë do të drejtohet nga Administratori i cili do të emerohet nga Keshilli Mbikqyres për një periudhë 3 vjetore me mundësi riemrimi. Në bazë të ligjit, Administratori do të nënshtrohet kontrollit të keshillit mbikqyres. Keshilli mbikqyres përcakton edhe shpërblimin e Administratorit në momentin e emerimit të tij.



Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i degës dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i keshillit mbikqyres së degës, dhe administratori i një dege nuk mund të jetë kryetari i keshillit mbikqyres i shoqërisë mëmë. Gjithashtu Administratori nuk duhet të jetë anëtarë i keshillit mbikqyres të vetë shoqërisë. Çdo emerim në kundërshtim me këto parashikime do të jetë i pavlefshëm.

Administratori i kryen funksionet e tij në përputhje me Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë tregëtare 9901, datë 14.4.2008 si dhe çdo rregullore të brendshme të Shoqërisë.

Administratori mund të shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres për shkaqe të përligjura. Vetë keshilli mbikqyres është organi kompetent i cili konstaton nëse ka shkaqe të përligjura për shkarkim ose jo.

Administratori ka këto kompetenca:

1. Menaxhon aktivitetin tregtar të shoqërisë tregëtare përmes vënies në zbatim të politikave të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
2. Përfaqëson shoqërinë tregëtare;
3. Kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe librave kontabël të nevojshëm;
4. Siguron dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe shumën e konsoliduar dhe raportin e punës dhe ia paraqet atë asamblësë së përgjithshme për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
5. Vendos një sistem të paralajmërimit të hershëm në lidhje me zhvillimet që rrezikojnë ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryen aksesimin e anëtarëve të Keshillit Mbikqyres me sistemin elektronik të menaxhimit të shoqërisë për informimin në distancë.
7. I ofron anëtarit të Keshillit Mbikqyres, brenda 3 ditëve pune, të gjithë informacionin e kërkuar prej tij, në lidhje me gjendjen financiare, gjendjen e llogarive bankare të shoqërisë, llogarinë në CASH dhe çdo lloj informacioni tjetër që ata e gjykojnë të nevojshëm, i cili lidhet me aktivitetin e shoqërisë.
8. Dorëzon informacionet e shoqërisë tregëtare për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj;



9. Jep llogari përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me vënien në zbatim të politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për rezultatin e shoqërisë tregtare.
10. Informon KM në lidhje me analizën e kostos së produktit objekt statuti;
11. Kryhen procedurat e konkurimit, në rastet e shpenzimeve të brendshme administrative të parashikuara nga programi ekonomik, kur vlera vjetore e prokurimit nuk është më e madhe se 3 milion lekë. Në rast se vlera është më e madhe atëherë miratimi duhet të jepet nga KM

Funksionet e përcaktuara nga ligji për anëtarët e keshillit mbikeqyres nuk mund të delegohen tek Administratori.

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Z. Alban Xhaferi, i biri i Ejupit lindur në Durrës e banues në Tiranë, i datelindjes 07.04.2011, identifikuar me kartë identiteti nr. 030174426, madhor dhe në zotësi të plote juridike për të vepruar.

NENI 21

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të ligjit për shoqëritë tregtare dhe në dispozitat përkatëse të këtij statuti për detyrimin e besnikërisë, Administratori detyrohet:

- a) të kryej detyrat e tij, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;
- b) të ushtroj kompetencat, që i njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësoj në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandaloj dhe të mënjanoj rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të garantoj miratimin e marrëveshjeve, sipas pikës 3 të nenit 13 të ligjit për shoqëritë tregtare;
- dh) të ushtroj detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tij, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratori, që vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i shpërblej shoqërisë dëmet,



që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kaloj çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator dhe/ose anëtar i këshillit të administrimit, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i shpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen aksionarëve kontributet;
- b) u paguan aksionarëve interesa apo dividendë;
- c) nënshkruan, blen, pranon si garanci apo anulon aksionet e shoqërisë;
- ç) emeton aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;
- d) shpërndan aktivet e shoqërisë;
- dh) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese, për të shlyer detyrimet;
- e) në rast të zmadhimit të kapitalit, emeton aksione përpara përmbushjes së kushteve apo kur kontributi nuk është kaluar sipas kërkesave të nenit 123 të ligjit për shoqëritë tregtare;
- ë) kryen pagesa në favor të anëtarëve të këshillit mbikqyrës;
- f) jep kredi.

NENI 22 PASQYRAT FINANCIARE

Administratori duhet të mbajë në rregull të gjithë llogaritë dhe të përgatisë raporte financiare të cilat reflektojnë kushtet financiare të shoqërisë në përputhje me parimet financiare. Të gjitha aktet e sipërpermendura duhet të jenë të përgatituara dhe të detajuara në formën e kërkuar nga ligji.

NENI 23 KONTROLLI I SHOQËRISE

Asambleja e përgjithshme, duhet të emerojë si auditore të pavarur të pakten 2 eksperte kontabel publike të pajisur me licensën perkatese të cilet do të kenë përgjegjësitë e mëposhtme:

- (a) Të kontrollojnë llogaritë e shoqërisë dhe të regjistrojnë të gjitha veprimet dhe transaksionet tregtare.

14



(b) Te vertetojne ne perputhje me regjistracionin ne fuqi, raportin vjetor te shoqerise si dhe deklaratat financiare te saj (bilancin, raportin mbi te ardhurat dhe humbjet e realizuara) si dhe te japin opinionin e tyre nese deklaratat financiare reflektojne realisht gjendjen financiare te shoqerise.

(c) Te informojne Administratorin, Keshillin Mbikeqyres si dhe Asamblene e Pergjithshme per cdo parregullsi, deficit te vezhguar ne veprimet, transaksionet, procedurat, regjistrimet, apo llogarite e shoqerise te cilat mund te sjellin si pasoje deme te konsiderueshme per shoqerine.

Eksperti Kontabel do te jete Shoqeria "Auditing Partners" sh.p.k., mbajtes i licenses Tatimore me NIP1'K 61703021 H , me License Nr.88 Ekspert Kontabel i Regjistruar.

Shoqeria do te kontrollohet nepermjet strukturave te saj administrative. Per kete arsye KM cakton nje apo me shume persona te cilet kanë te drejte te auditojne shoqerine ne menyre permanente, sipas nje programi te miratuar prej saj.

Kriteret dhe menyra e perzgjedhjes se tyre percaktohen nga KM.

NENI 24 REGJISTRIMI I AKSIONEVE



Shoqeria ruan ne nje regjister te vecante te gjitha detajet dhe te dhemat e aksionereve si psh: emri, mbiemri, apo emri i regjistruar nese eshte person juridik, vleren nominale te aksioneve, adresat e banimit apo selive si dhe daten e regjistrimit.

Personat e Regjistruar ne perputhje me piken nje te ketij neni, konsiderohen si aksioncret e shoqerise me te drejta te plota ndaj shoqerise ai dhe ndaj personave te trete.

Administratori eshte pergjegjes per mirembajtjen e regjistrit te aksioneve te shoqerise dhe jane te detyruar te lejojne aksesin ne kete regjister per cdo aksioner apo cdo person tjeter qe kerkon informacion.

NENI 25 TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet mund te transferohen nepermjet nje kontrate midis shitesit dhe bleresit. Bleresi konsiderohet si aksioner qe nga momenti i regjistrimit te transaksionit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.


15




E DREJTA E PARABLERJES

Aksionet janë lirisht të transferueshme midis aksionereve si dhe midis aksionerit person juridik dhe ortakeve/aksionereve të tij.

Parashikimet e paragrafit të parë do të aplikohen dhe për transferimin e aksioneve midis aksionerit person juridik dhe bashkeshortëve dhe/ose femijeve të ortakeve/ aksionereve të tij.

Në rast të transferimit të aksioneve sipas parashikimeve të paragrafit të parë dhe të dytë, aksioneri që transferon aksionet e tij, duhet të njoftojë me shkrim shoqërinë dhe aksionerët e tjerë për këtë kalim.

Në rast të transferimit të aksioneve nga njëri aksioner drejt personave të tretë jashtë shoqërisë, oferta do t'u paraqitet me parë aksionereve të shoqërisë me të njëjtat kushte që do t'i jepte një personi të tretë. Aksioneri shitës detyrohet të njoftojë me shkrim shoqërinë për numrin e aksioneve që do të shesë, cmimin e tyre, si dhe çdo kusht tjetër specifik.

Aksionerët e shoqërisë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin aksioner, 30 dite nga vendimi i Asamblesë për pranimin ose mos pranimin e ofertes. Nëse njëri nga aksionerët do të refuzojë të blejë numrin e tij të ofruar të aksioneve, aksioneri transferues do t'ia komunikojë këtë refuzim edhe aksionereve të tjerë. Aksionerët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes 7 dite nga njoftimi për refuzimin e blerjes së aksioneve. Për qëllimet e këtij neni, të gjitha njoftimet do të behen nepërmjet postës së shkruar, faksit, apo postës elektronike.

Parashikimet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni nuk do të aplikohen për shitje apo transferime të kryera nga një aksioner në favor të një aksioneri. Megjithatë, në raste të tilla, transferimi duhet paraprakisht të komunikohet, në formë shkresore tek aksionerët e tjerë.

Zmadhimi i Kapitalit

NENI 27

Kushtet për të gjitha format e zmadhimit të kapitalit

1. Zmadhimi i kapitalit kryhet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me nenin 8 të këtij statuti.
2. Kur zmadhimi i kapitalit ndryshon të drejtat, që rrjedhin nga zotërimi i një kategorie aksionesh, vlefshmëria e vendimit të asamblesë së përgjithshme i nënshtrohet pëlqimit të aksionarëve të prekur, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.
4. Nënshkrimi, shlyerja e kalimin e kontributeve për aksionet, e, në veçanti, kërkesat e parashikuara në nenet 107 deri në 114 dhe 123 deri në 133 të ligjit për shoqëritë tregtare, zbatohen edhe për rastin e zmadhimit të kapitalit.





NENI 28

Regjistrimi dhe publikimi i rritjes së kapitalit

1. Administratori detyrohet të njoftoj për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.
2. Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë, sipas nenit 113 të ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqërues duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.
4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 29

Ndalimi i emetimit të aksioneve

Përpara se zmadhimi i kapitalit të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, aksionet e reja nuk mund të emetohen dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen. Aksionet e emetuara në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshme. Personat, që kryejnë shkeljen, përgjigjen ndaj nënshkruësve në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga një emetim i pavlefshëm.

NENI 30

Fillimi i pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e emetimit, aksionet e reja marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit financiar, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.
2. Vendimi për zmadhimin e kapitalit mund të parashikojë, që aksionet e reja të marrin pjesë nga fitimet e vitit financiar, që i paraprin vitit, në të cilin është marrë vendimi për këtë zmadhim.

NENI 31

Kushtet

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.



NENI 32

E drejta e parablerjes

1. Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar, që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet jo më vonë se 20 ditë pas publikimit të parashikuar sipas nenit 169 ligjit për shoqëritë tregtare.
2. Të drejtat e përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohen ose të përjashtohen nga vendimi i asamblesë së përgjithshme për zmadhimin e kapitalit. Administratorët duhet t'i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport, ku të jepen arsyet për kufizimin ose përjashtimin e këtyre të drejtave dhe ku të justifikohet çmimi i emetimit të propozuar. Ky vendim mund të merret vetëm nëse kufizimi ose përjashtimi i të drejtave është publikuar më parë në hapësirën në internet të shoqërisë dhe njoftuar për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 33

Kushtet për zmadhimin e kufizuar të kapitalit

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.
2. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

NENI 34

Kushtet

1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlere më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.
3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

NENI 35

Shpërndarja proporcionale e aksioneve të emetuara rishtazi

Aksionarët kanë të drejtë të zotërojnë aksionet e emetuara rishtazi në përpjesëtim me aksionet e tyre, përpara rritjes së kapitalit. Çdo vendim i asamblesë së përgjithshme, që bie ndesh me këtë dispozitë, është i pavlefshëm.





ZVOGËLIMI I KAPITALIT NENI 36

Kushtet për zvogëlimin e kapitalit

1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e nenit 12 të këtij statuti.
2. Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të ligjit për shoqëritë tregtare.
3. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve.
4. Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në nenin 107 të ligjit për shoqëritë tregtare, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

NENI 37

Regjistrimi dhe publikimi i vendimit

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ky vendim duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

NENI 38

Mbrojtja e të drejtave të kreditorëve

1. Kreditorët, pretendimet e të cilëve janë ngritur përpara datës së publikimit të vendimit për zvogëlimin e kapitalit, kanë të drejtë të marrin garanci të mjaftueshme nga shoqëria për kreditë, që nuk ishin bërë të kërkueshme përpara datës së publikimit të vendimit. Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm nëse kreditorët kërkojnë garancinë brenda 90 ditëve, pas datës së publikimit.
2. Përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe përpara se kreditorët përkatës të jenë shlyer apo të kenë marrë garanci të mjaftueshme, shoqëria nuk mund të kryejë pagesa në favor të aksionarëve ose falje të detyrimeve për të shlyer kontributet, si pasojë e zvogëlimit të kapitalit.

NENI 39

Regjistrimi dhe publikimi i zvogëlimit të kapitalit

1. Administratorët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për zvogëlimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
2. Kapitali qubet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të vendimit.





Kushtet për zvogëlimin e thjeshtëzuar të kapitalit

1. Zvogëlimi i kapitalit për mbulimin e humbjeve, si dhe transferimi i fondeve të rezervat kryhen nëpërmjet një procedure të thjeshtuar.
2. Nenet e këtij statuti në lidhje me zmadhimin e thjeshtuar të kapitalit, janë të zbatueshme edhe për rastin e zvogëlimit të thjeshtuar të kapitalit.

NENI 41 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DIVIDENTET

Cdo aksioner do të ketë të drejtën që perkundrejt aksioneve që zoteron në shoqëri të marrë pjesë në fitimet realizuara në masën e përcaktuar nga asamblëja e përgjithshme. Fitimet do të perlllogatiten në përputhje me parimet e legjislacionit financiar në fuqi.

NENI 42 NDRYSHIMET

Ky dokument mund të ndryshohet, ose një statut i ri mund të përshtatet nëpërmjet vendimit të Asamblës së Përgjithshme, me anë të shumicës së përcaktuar në njoftimin për mbledhjen e Asamblës.

NENI 43 PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria mund të prishet apo përthithet nëpërmjet vendimit të Asamblës së Përgjithshme me praninë e aksionerëve që përfaqësojnë ¼ të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria anonime prishet :

- Kur mbaron periudha kohore për të cilën është themeluar;
- Me vendim të asamblës së përgjithshme;
- Me hapjen e një procedure falimentimi;
- Nëse nuk është kryer aktivitet tregtarë për dy vjet;
- Me vendim të gjykatës;
- Për arsye të tjera.

Në rastin e prishjes së shoqërisë, Administratori deklaron dhe depoziton aktet përkatëse për prishjen e shoqërisë pranë QKR. Në rast të prishjes në bazë të një vendimi gjyqësor, gjykata regjistron prishjen *ex officio*.

Ulja e numrit të aksionerëve në një të tillë nuk çon në shpërbërjen e shoqërisë.



Tiranë, 19.04.2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J81813004C
2. Data e Regjistrimit	11/06/1998
3. Emri i Subjektit	HYSENBELLIU
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	10/06/1998
6. Kohëzgjatja	Nga: 10/06/1998
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Panorama, Prane Hotel Prestige, Zona Kadastrale 8330 Pasuria nr.8/205
8. Kapitali	248.006.810,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Bar, restorant, Pub, birrari, hoteleri turizem. Import-eskport te mallrave te ndryshme industriale, bujqesore, ushqimore, mjekesore si dhe shitjen e tyre me shumice dhe pakice, tregtimi i dritherave, perimeve, frutave, perpunimin e tyre, tregtimin e pijeve alkolike dhe freskuese, ujit, duhan-cigare, tregtimin dhe perpunimin e lekureve, tekstileve dhe konfeksioneve, tregtimin e artikujve mekanike, paisjeve elektrike, telefonike, materiale ndertimi dhe paisje hidrosanitare, letres. "Organizimi i eventeve, dasma, ditelindje, pishina, akomodim, SPA, hapja dhe menaxhim i sallave konferencash, aktivitete turistike, organizime te ndryshme. Kryerja e sherbimeve te stacioneve te plazhit. Hapja menaxhimi dhe funksionimi i qendrave te rekreacionit, trajtimit te lekures dhe te trupit, fitnes, dhenia e ambienteve me qira si dhe gdo veprimtari tjeter te lejuar nga ligji.
10. Administratori/ët	Klesta Xhaferri
10.1 Afati i emërimit	Nga: 08/07/2019 Deri: 08/07/2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<p>11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>	<p>Administrimin e aktivitetit që ushtron shoqëria në adresën sekondare të shoqërisë: "Tirane Golem, Fshati Turistik Mak - Albania" duke pasur të drejtë të ushtrime të gjitha tagrat e lejuara nga ligji dhe statuti në këtë vend ushtrimi veprimtarie. Nuk lejohet administrimi i llogarive të shoqërisë në të gjitha bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, nuk lejohet të kryhet asnjë veprim bankar, si por pa u kufizuar në: pagesa, urdhëra xhirimi, tërheqje, depozitim, si dhe çdo lloj veprimi tjetër i mundshëm në bankat e nivelit të dytë.</p>	
<p>12. Administratori/ët 12.1 Afati i emërimit</p>	<p>Arta Sino Nga: 30/09/2019 Deri: 30/09/2020</p>	
<p>13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>	<p>Arta Sino të këtyre tagrat për të kryer veprime bankare në llogaritë e shoqërisë. Të miratojë shtimin e financieres së shoqërisë Znj. Eliana Abule, që së bashku me administratoren e shoqërisë të nënshkruajë çdo veprim bankar në emër dhe për llogari të shoqërisë si por pa u kufizuar në: pagesa, urdhëra xhirimi, tërheqje, depozitim si dhe çdo lloj veprimi tjetër të mundshëm financiar.</p>	
<p>14. Ortakët 14.1 Vlera e kapitalit 14.2 Numri i pjesëve 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) <i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuota si përfaqësues)</i></p>	<p>Irfan Hysenbelliu Para: 248.006.810,00 Natyre: 100,00 100,00</p>	
<p>15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit</p>	<p>Tirane Golem Golem Fshati Turistik Mak- Albania</p>	
<p>16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht</p>	<p>Emri Tregtar: HYSENBELLIU E-Mail: m.kulla@hysenbelliugroup.com Telefon: 0699183554</p>	
<p>17. Statusi:</p>	<p>Aktiv</p>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 16/12/2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web



Data: 11 Dhjetor 2019

LETET ANGAZHIMI

Implementimi i ketij angazhimi eshte subjekt i perfundimit te kontrollit/investigimit/auditimit te metejshem, aprovimit te autoriteteve perkatese te Tirana Bank, dhe paraqitjes/plotesimit te te gjithe dokumentacionit ligjor te mjaftueshem (kontrata kredie, kontrata hipoteke, etj...) si dhe kushteve para disbursimit. Informacioni i paraqitur ne kete dokument eshte pergatitur per palet e interesuara dhe konsiderohet konfidencial. Ky dokument nuk mund t'i behet i ditur ne asnje menyre paleve te treta pa aprovimin paraprak me shkrim te Tirana Bank.

Kjo leter angazhimi nuk perben detyrim ligjor per Tirana Bank.

Vlefshmeria e ketij dokumenti eshte deri ne 11.01.2020.

Subjekt: Angazhim per aprovimin e kredise afatgjate ne shumen EUR 4,000,000 (kater milion euro) me qellim blerjen e aksioneve te zoteruara nga z.Alban Xhaferi dhe shoqëria "AL & GI" sh.p.k te cilat perfaqesojne 34% te kapitalit te aksioneve te Shoqerise "Birra Tirana" sh.a.

Tirana Bank me nenshkrimin e ketij dokumenti, ju njofton se po trajton kerkesen e klientit shoqërisë "Hysenbelliu" sh.p.k i cili konsiston ne financimin e nje kredie afatgjate ne shumen EUR 4,000,000 (kater milion euro) **me qellim blerjen e aksioneve** te zoteruara nga z.Alban Xhaferi dhe shoqëria "AL & GI" sh.p.k te cilat perfaqesojne 34% te kapitalit te aksioneve te Shoqerise "Birra Tirana" sh.a.

Tirana Bank do te procedoje me aprovimin e kesaj kredie afatgjate nga autoritetet perkatese vendimarrëse vetem ne rastin e plotesimit te kushteve te meposhtme:

1. Nenshkrimi i kontratave përkatëse per Shitblerjen e Aksioneve te shoqerise "Birra Tirana" sh.a;
2. Si edhe kushteve te tjera jo shteruese.

Me respekt,

Perfaqesuesi e Tirana Bank

Glenda Kurti

